AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Indeksi i Çmimeve të Importit (IÇIMP), TM2 2023

01.09.2023
Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon Indeksin e Çmimeve të Importit (IÇIMP) për tremujorin e dytë (TM2) 2023, viti bazë 2010=100.

Çmimet e importit më të larta në TM2 2023 sesa në TM2 2022

Indeksi i tërësishëm i çmimeve të importit në Kosovë u ngrit për 1,1% në TM2 2023, krahasuar me TM1 2023. Ndërkaq, krahasuar TM2 2023 me TM2 2022 çmimet e importit u ngritën në një mesatare prej 5,0%.



Tremujori i dytë 2023 / Tremujori i parë 2023 1,1%

Çmimet e importit në Kosovë patën një ngritje në një mesatare prej 1,1% në TM2 2023, krahasuar me TM1 2023. Ngritje më të mëdha të çmimeve sipas sektorëve ishin te: instrumentet optike, fotografike, matëse, medicinale, muzikore dhe mekanizmat e orës (14,5 %); tekstili dhe artikujt e tekstilit (11.9%); lëkura dhe artikujt e saj (11,5%); etj.

Ngritja u neutralizua, kryesisht nga rënia e çmimeve sipas sektorëve te: vajrat ushqyese (-12,3%); këpucët (-3,4%); plastika, kauçuku dhe artikujt e tyre (-2,2%); metalet bazë dhe artikujt e metaleve bazë (-2,1%); etj.

Tremujori i dytë 2023 - Tremujori i dytë 2022 5,0%

Çmimet e importit në Kosovë u ngritën në një mesatare prej 5,0% në TM2 2023, krahasuar me TM2 2022. Ngritje më të mëdha sipas sektorëve ishin te: produktet bimore (27,6%); letra dhe artikujt e saj (19,4%); tekstili dhe artikujt e tij (17,9%); instrumentet optike, fotografike, matëse, medicinale, muzikore dhe mekanizmat e orës (13,5%); mjetet e transportit (12,8%); lëkura dhe artikujt e saj (10,2%) etj.

Ngritja u neutralizua, kryesisht nga rënia e çmimeve sipas sektorëve te: vajrat ushqyese (-11,5%); metalet bazë dhe artikujt e metaleve bazë (-5,9%); plastika, kauçuku dhe artikujt e tyre (-5,2%) dhe produktet minerale (-3,2%).

Ndryshimet tremujore dhe vjetore në % sipas sektorëve

Grupi	Pesha	TM2- 2023 2010 =100	TM2 - 2023 TM1-2023	TM2 - 2023 TM2 - 2022
IÇIMP - Gjithsej	**1000**	**163.8**	**1.1**	**5.0**
Shtazët e gjalla; produktet e shtazëve	38	180.6	-0.5	9.5
Produktet bimore	50	351.4	5.0	27.6
Vajrat ushqyese	10	205.3	-12.3	-11.5
Artikuj ushqimor të përgatitur, pijet dhe duhani	131	130.7	1.3	8.3
Produktet minerale	147	235.1	-0.3	-3.2
Produktet e industrive kimike	80	126.7	0.1	7.5
Plastika,kauçuku dhe artikujt e tyre	64	158.1	-2.2	-5.2
Lëkura dhe artikujt e saj	2	122.9	11.5	10.2
Druri dhe artikujt e tij	26	182.3	-1.7	0.3
Letrat dhe artikujt e saj	16	126.1	-0.2	19.4
Tekstili dhe artikujt e tekstilit	44	102.2	11.9	17.9
Këpucët	12	143.2	-3.4	1.4
Artikutj e gurit, të llaçit, produktet e keramikës dhe te qelqit	34	195.2	-0.8	9.4
Margaritarët, gurët e çmuar, metalet, etj.	:	:	:	:
Metalet bazë dhe artikujt e metaleve bazë	100	170.6	-2.1	-5.9
Paisjet e makinerisë dhe pajisjet elektrike	118	122.4	0.3	3.2
Mjetet e transportit	88	147.9	6.7	12.8
Instrumentet optike, fotografik, matës, medicinal dhe muzikorë dhe mekanizmat e orës	10	127.8	14.5	13.5
Armët dhe municioni	:	:	:	:
Artikujt e ndryshëm të prodhuar	28	131.7	1.9	3.2
Veprat e artit	:	:	:	:

Për më shumë informata, lidhur me publikimin e Indeksit të Çmimeve të Importit (IÇIMP) për tremujorin e dytë TM2- 2023, vizitoni: https://ask.rks-gov.net/Themes/PricesAndInflation